

VENDIM
“Per heqjen e Sekuestros”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere nga :

GJYQATAR : ARJAN ALIAJ

Asistuar prej sekretares gjyqesore Denisa Xhafa dhe me pjesemarrjen e prokurorit Endrit Bimi sot me date 07.11.2016 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore kerkesen penale nr. 1047 Regj.Themaltar qe i perket :

KERKUESE : L. T. e bija e G.t e dtl. 14.02.19.. lindur ne ... Diber dhe banuese ne ... Tirane perfaqesuar ne gjykim me prokure te posaçme nr.445 rep dhe 132 kol date 04.02.2016 nga Av. Melita Murati .

OBJEKTI: Kundershtim i Vendimit te Prokurorise dhe heqje e sekuestros preventive te vendosur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane sipas vendimit date 19.09.2015.

BAZA LIGJORE : Neni 36 i K.Penal, Nenet 270,274 dhe 470 te K.Pr.Penale.

Gjykata si njoftoj palet per seancen gjyqesore te dates 07.11.2016 dhe degjoje perfaqesuesen e kerkueses qe kerkoj pranimin e kerkeses dhe perfaqesuesin e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane qe kerkoj pranimin e kerkeses.

VËREN

Se kerkuesia L. T. me kerkesen drejtuar Gjykates ka kerkuar: Kundershtimin e Vendimit te Prokurorise dhe heqjen e sekuestros preventive te vendosur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane sipas vendimit date 19.09.2015.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezultoj se:

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane mbi bazen e materjalit kallezues te Drejtorise Policise Qarkut Tirane referuar shkreses nr. ... date 18.09.2015 ka regjistruar procedimin penal nr.7245 date 18.09.2015 per kryerjen e vepres penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale” parashikuar nga neni 287 i K.P. Nga referimi i vepres penale ne emer te shtetases L. T. disponohen te dhena si me poshte;

Me date 09.07.2015 llogaria e kesaj shtetase eshte kredituar per shumen 100 000

USD nga nje transferte nga ishujt Mauritius me banke ndermjetese ne Viene, Austri dhe me urdherues shtetasin R. A. Sh. me adrese " ... ,UK" me burim te dyshimte.

Ne daten 24.03.2015 shtetasja L. T. ka perfituar shumen 25 000 paund nga nje transferte nga Republika Çeke me urdheruese shtetasen H. M. me adrese ... CZE Banka

ndermjetese qe ka kryer transfertin eshtene Londer UK. Ne daten 26.02.2014 ka perfituar nje transferte nga Britania e Madhe per shumen prej 5000 paund me urdherues shtetasin Sh. S. me adrese "...". Per shkak se shumate e perfituara nga shtetasja

L. T. jane nga urdherues qe bazuar ne gjeneralitetet e tyre nuk rezulton te

jene familjar te saj duke pasur dyshime ne lidhje me burimin e ketyre fondeve dhe per nje hetim te plote e te gjithaneshem Organi i Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane ka vendosur sekuestriminprane Bankes Raiffeisen te sasise se parave. Gjate gjykimit rezultoj se nga shkresa nr.... prot D.S. date 13.06.2016 e Ministrise se Drejtesise, Drejtoria e MarredhenjeveJuridiksjonale me Jashte nuk rezulton qe shtetasja H. M. te jete person i dyshuar, ne ndjekje ose ne verifikim nga Policia si dhe nuk ka asnje te dhene per vendime te Gjykates perpara vitit 2010 dhe perpara dates 01.02.2016.Gjitheashtu nga shkresa nr.... Prot ... date 24.10.2016 e Ministrise se

Puneve te Brendeshme Zyra Qendrore Kombetare Interpol Tirana rezulton se nga informacioni policor per shtetasitL. T., A. Sh. R. , I. S. T. dhe D. G. D. shtetasit L. T. dhe A. R. te dhenat per ta rezultojne negativ.

Referuar Informacioneve te mesiperme perfaqesuesi i Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane i kerkoj gjykates pranimin e kerkeses, me arsyetimin se nuk konfirmohet qe te ardhurat nga shtetasja çeke jane te ardhura qe burojne nga aktivitet kriminal. Me kerkesen e perfaqesuesit te akuzes ishte dakort edhe perfaqesuesja e kerkueses L. T..

Gjykata si analizoj provat e marra ne gjykim,prej te cilave nuk konfirmohet se te ardhurat e derguara kerkueses burojne nga aktivitet kriminal dhe ne kushtet kur vete perfaqesuesi i akuzes kerkoj pranimin e kerkeses per heqjen e sekuestros se vendosur me vendimin e dates 19.09.2015 çmon te pranoje kerkesen e kerkueses L. T. duke hequr sekuestron e vendosur ne date 19.09.2015 nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane.

PËR KËTO ARËSYE

Gjykata bazuar ne nenin 210 te K.Pr.P.

VENDOSI

-Pranimin e kërkesës së kërkueses L. T..

-Heqjen e sekuestros së vendosur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tiranë me vendimin e datës 19.09.2015.

-Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë sipas ligjit
- U shpall ne Tirane sot me date 07.11.2016.

SEKRETARE

DENISA XHAFI

GJYQTAR

ARJAN ALIAJ